



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 129 prot.

Kamëz, më 27.09.2022

V E N D I M

Nr. 1/0 Datë 07 / 09 2022

MBI

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 07.09.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.97 Datë 07.09.2022, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.531, datë 29.06.2022 dhe urdhërit nr. 569, datë 14.07.2022 për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesa, relacioneve të hartuar në zbatim të urdhërave dhe V.K.B. Kamëz Nr. 132, datë 22.12.2021 “Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2022, 2023 dhe 2024, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Drejtorsë Emergjencave Civile dhe Strehimit për mbështetje financiare të familjeve të z. Besim Gjoka, për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 28.06.2022 dhe Leonard Kurti për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 10.07.2022.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar nga komisioni i vlerësimit në zbatim të Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë “për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuara në banesat e z. Besim Gjoka dhe Leonard Kurti.
3. Te akordohet një ndihmë financiare për këto familje sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Vlera e dëmit lekë	Për pagesë 50% e vlerës në lekë sipas VKM-së nr. 329, dt. 16.05.2012
1	Besim Gjoka		
2	Leonard Kurti		
	TOTALI		



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Ndihma financiare për dy familjet e dëmtuara përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

